



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 610/1 prot.

Tiranë më 8.6.2020

Lënda: Mendim mbi një protokoll bashkëpunimi

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 2511/1 prot., datë 28.05.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim draftin e "*Protokollit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Italisë mbi bashkëpunimin në fushën e formimit policor*", Zyra e Komisionerit vlerëson se në tërësi drafti është hartuar konform ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Sugjerojmë që në nenin 6 të Protokollit, të hiqet fjala "*sensitive*", pasi referuar pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", e dhënë sensitive është "*Çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale*".

Nga objekti i Protokollit, kuptojmë që nuk kemi të bëjmë me përpunim të dhënash sensitive.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

